

Nr.: YIHR-KS-02-5633-24-02-17

Për: Kuvendin e Kosovës
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Nga: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë

KËRKESË

Index: YIHRKS -02-5633-24-02-17
Data: 24.02.2017
Vendi: PRISHTINE

**I nderuari Kryesues,
Të nderuar/a Anëtarë të Komisionit,**

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë përmes kësaj letre kërkon nga Kuvendi i Kosovës përkatësisht Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport që të organizojë dhe thërrasë në raportim Ministrin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Autorëve dhe Shtëpive Botuese të teksteve shkollore para-universitare.

Arsyetim

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë – YIHR KS, nga mesi i vitit 2016 ka ndërmarrë iniciativën dhe është duke zbatuar programin “Pjesëmarrja e të rinjve në edukim gjithëpërfshirës”, program ky i mbështetur nga USAID/ATRC në kuadër të Programit të USAID-it Angazhimi për Barazi (E4E).

Komponentë e parë e këtij programi është identifikimi, analizimi dhe adresimi i gjuhës diskriminuese në programet dhe tekstet shkollore të nivelit parauniversitar, përkatësisht Arsimit të Mesëm të Lartë (Klasat X-XII). Arsyeja për ndërmarrjen e një iniciative të tillë kanë qenë rastet kur nga individ e organizata të ndryshme është bërë identifikimi i gjuhës diskriminuese në tekstet shkollore. Duke pas parasysh këtë situatë YIHR KS ka vendosur që të përdorë një qasje sistematike të identifikimit të gjuhës diskriminuese, analizimit të saj dhe ofrimit të rekomandimeve konkrete për përmirësimin e kësaj gjuhe në programet dhe tekstet shkollore parauniversitare.

Të dhënat e para të kësaj analize të realizuar nga stafi i YIHR KS tregojnë për një nivel alarmant të pranisë së gjuhës diskriminuese, jo-objektive, e pa bazuar në fakte shkencore dhe përjashtuese për shumë komunitete që jetojnë në shoqërinë tonë.

Për këtë është e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë ligjvënës dhe mbikëqyrës i institucioneve të Republikës së Kosovës të përfshihet në këtë iniciativë për ri-shikimin e teksteve shkollore dhe të ndikojë që ky proces të jetë profesional dhe gjithëpërfshirës.

Shpresojmë që së shpejti të marrim përgjigje pozitive lidhur me këtë kërkesë.

Me respekt,

Teuta Hoxha
Drejtoreshë Ekzekutive

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë
Rr. Rexhep Mala, Nr.9, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 748 018; +386 49 795 100
E-mail: teuta@yih.org
Ueb: www.yih.org